




DETYRE PROJEKTIMI

**OBJEKTI: KALIMI I FIDERIT C6 20KV ,
N/STACIONI TRAKTORA 110/20/6KV ,
NGA LINJË AJRORE NË KABLLORE “**



PËRMBAJTJA

1.HYRJE.....	3
1.1Objekti i Detyres se Projektimit	3
1.2.Referimet Ligjore dhe Teknike	3
1.2.1.Referimet ligjore	3
1.2.2.Referimet teknike	4
2.KERKESAT AMBIENTALE DHE PARAMETRAT ELEKTRIK TE SISTEMIT	5
3.PROJEKTI I RI 20 KV	6
3.1.Domosdoshmeria, arsyeja e kryerjes se investimit	6
3.2.Qellimi i Projektit	6
3.2.1.Rrjeti i ri TM 20 kV	7
3.2.2.Kabinat e Reja dhe ato ekzistuese	7
3.2.3.Rrjeti i tensionit te ulet	8
4.Vizatimet	8
5.Specifikimet e materialeve	9
6.Materialet qe do te demontohen	9
7.Ceshtjet ambientale.....	9
8.Dokumentacioni.....	9
9.Realizimi i projektit	10



1. HYRJE

Rajoni i Tiranë është ndër rajonet më të mëdha të Shqipërisë. Qyteti Tiranë dhe zonat periferike të sajë karakterizohen nga një zhvillim intensiv i gjithanshëm, vecanerisht i ndertimeve ne zonen urbane te saj. Keta faktor kane bere qe ritmet e rritjes se kerkeses per energji elektrike te jene mjaft te larta. Për zonën bregdetare duhet zhvilluar një infrastrukture elektrike e përshtatshme, që të garantojë një shërbim cilësor kundrejt konsumatoreve aktual dhe njëkohësisht të jetë në përputhje me zhvillimet e pritshme afatgjata të zonës. Referuar strategjisë së zhvillimit dhe përmirësimit të rrjetave elektrike që kompania OSSH sh.a. ka, ndër të tjera dhe normalizimin e ngarkesave në linja TM, kabina transformacioni dhe rrjetin TU dhe për tju përgjigjur zhvillimit urbanistik dhe demografik të zonës së Tiranës është hartuar kjo detyre projektimi me qëllim hartimin e projektit te furnizimit me energji elektrike shtrihet në zonën e Shkozës nga dalja e Nënstacionit Traktora pergjate rrugeve “Unaza e Madhe Shkoze”, “Agush Gjergjevic”, “Rruga e Mumajeseve”, “Pasho Hysi” dhe “Idriz Dollaku” ,deri ne pjesen fundore te Lagjes”Ali Demi”.

Projekti përmban linjat e tensionit të mesëm 20 kV, kabina transformacioni me tension 20/0.4kV si dhe ndërtimin e rrjetit të tensionit të ulët. Ky projekt është i nevojshëm pasi kjo zone aktualisht ka një rrjet në gjendje të keqe teknike, shumë të ngarkuar dhe me humbje të larta teknike dhe jo teknike.

Projekti përfshin një zonë gjeografike prej 12.9 km² km² dhe rreth 1545 abonentë (familjarë dhe privatë).

Më poshtë është përshkrimi për gjendjen ekzistuese të rrjetit TM për zonën që do të kryhet investimi, projekti i ri dhe materialet që do të përdoren për zbatimin e projektit dhe llogaritjet teknike.

1.1. Objekti i Detyres se Projektimit

Objekti i detyres se projektimit është për të dhene piketat ne te cilat duhet te mbeshtetet grupi i projektimit per te hartuar projektin e rrjetit shperndarese se nenstacionit Traktora .

Ne rast se gjet projektit konstatohen gjetje te cilat mund te permiresojne projektin te cilat dalin nga kjo detyre projektimi atehere grupi i projektimit duhet te pergatise nje relacion ku te pershkruben gjetje dhe ndryshimet qe duhen bere detyres se projektimit. Gjithashtu relacioni duhet te permbaje dhe avantazhet te cilat do te sjellin keto ndryshime.

1.2.Referimet Ligjore dhe Teknike

Projekti duhet te hartohet ne perputhje me referencat teknike dhe ligjore si me poshte:

1.2.1. Referimet ligjore

- Ligji Nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”
- Vendimi i ERE nr.100, date 26.8.2008 “Kodi_Shpërndarjes”
- Vendimi i ERE nr.101, date 2.8.2008 “Kodi Matjes”
- ERE “Per Lidhjet e Reja ne Sistemin e Shperndarjes”
- “Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet, Instalimet dhe Paisjet Elektrike”
- Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”

- Vendim i KM nr.564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores “Për kerkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”
- VKM 482 17.6.2020 “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”
- VKM 483 17.6.2020 “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV”
- Ligji nr.8405, date 17.9.1998 për “Urbanistikën”
- Ligji nr.8402, date 10.9.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”
- Ligji Nr. 10 440, dt 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”
- Ligji Nr.9537 date 18.05.2006 “Për Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme (i përmirësuar me Ligjin Nr.9890 date 20.03.2008)”
- Ligji nr. 8934, date 5.9.2002 për “Mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 “ Për zonat e mbrojtura ”
- VKM Nr.249, dt 24.04.2003 “Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementeve të Lejes Mjedisore”

1.2.2. Referimet teknike

- SSH EN 60947 Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët (Low-voltage switchgear and controlgear)
- S SH EN 50274:2002: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët e rrezikshme nën tension
- SH EN 50274:2002/AC:2009: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët që përbejnë rrezik për jetën
- SSH EN 60898-2:2006: Ndërprerësit e tensionit për mbrojtjen nga mbirryma për instalimet shtëpiake dhe të ngjashme me to — Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut për veprimin e rrymës alternative dhe rrymës së vazhduar
- SSH EN 60947-5-4:2003:Pajisjet shpërndarëse të tensionit të ulët - Pjesa 5 - 4: Pajisjet e qarkut të kontrollit dhe elementët ndërprerës - Metoda e vlerësimit të performancës së kontakteve me energji të ulët - Prova të veçanta (ose ekuivalentet e tyre)
- SSH HD 361 S3:1999 Sisteme për projektimin e kabllave
- SSH HD 361 S3:1999/A1:2006
- SSH HD 361 S3:1999/AC: 1999
- SSH HD 516 S2:1997: Udhëzues për përdorimin e kabllave të harmonizuara të tensionit të ulët
- SSH HD 516 S2:1997/A1:2003
- SSH HD 516 S2:1997/A2:2008
- SSH HD 603 S1:1994: Kabllot e shpërndarjes me tension të vlerësuar 0,6/1 kV
- SSH HD 603 S1:1994/A1:1997
- SSH HD 603 S1:1994/A2:2003
- SSH HD 603 S1:1994/A3:2007



- SSH HD 604 S1:1994: Kabllot e fuqise 0,6/1 kV dhe 1,9/3,3 kV me performance speciale ndaj zjarrit per perdorim ne stacionet dektrike
- SSH HD 604 S1:1994/A1:1997
- SSH HD 604 S1:1994/A2:2002
- SSH HD 604 S1:1994/A3:2005
- SSH HD 605 S2:2008: Kabllo elektrik - Metodot shtese te proves
- SSH HD 605 S2:1994/AC:2010
- SSH HD 627 S1:1996/A1:2000
- SSH HD 627 S1:1996/A2:2005
- SSH EN 50363-0:2011 Materialet e izolimit, mbuluese dhe veshese per kabllot e energjise me tensioni te ulet – Pjesa 0: Paraqitje e pergjithshme
- SSH EN 50363-3:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 3: Materalat elektroizoluese prej PVC-je
- S SH EN 50363-4-1:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat veshese prej PVC-je
- S SH EN 50363-4-2:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat mbuluese prej PVC-je
- SSH EN 50395:2005: Metodot elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet
- S SH EN 50396:2005: Metodot jo elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet
- SSH EN 60228:2005: Percjellesit e kabllove te izoluar
- SSH IEC 60479 Efektet e rrymë mbi trupin e qënieve njërëzore dhe bagëtime

2. KERKESAT AMBIENTALE DHE PARAMETRAT ELEKTRIK TE SISTEMIT

Kerkesat ambientale:

- | | |
|--|----------|
| • Temperatura Max. e ambientit | + 40°C |
| • Temperatura Min. e ambientit | - 20°C |
| • Temperatura Max. mesatare | + 30°C |
| • Temperatura mesatare vjetore ne ajer | + 15°C |
| • Lageshtia Relative Max. | 80 % |
| • Shpejtesia Max. e eres | 130 km/h |
| • Lartesia Max. nga niveli detit | 1000 m |

Parametrat e rrjetit TU:

- | | |
|----------------------------------|-------------------------|
| • Tensioni nominal i sistemit | 230/400 V |
| • Tensioni më i lartë i sistemit | 0.66 kV |
| • Numri i fazave | 3 |
| • Frekuenca | 50 Hz |
| • Sistemi i tokezimit | i lidhur direkt ne toke |

Parametrat e rrjetit 20 KV:



- Tensioni nominal i sistemit 20 kV
- Tensioni më i lartë i sistemit 24 kV
- Numri i fazave 3
- Frekuenca 50 Hz
- Sistemi i tokezimit i izoluar
- Qendrushmeria ndaj LSH
 - Nenstacionet Primare 31.5 kA (3s)
 - Kabinat Shperndarese 20 kA (1s)

Distanca minimale e izolimit: 25 mm/kV

3. PROJEKTI I RI 20 kV

3.1. Domosdoshmeria, arsyeja e kryerjes se investimit

Ky investim eshte planifikuar te kryhet per arsye se:

- Zona ne te cilen zhvillohet projekti ka nje trend te lart te rritjes se kerkeses per energji
- Zona aktualisht ka humbje te larta
- Zona ka cilesi te dobet te furnizimit me energji elektrike
- Zona aktualisht furnizohet me tension 6 kV
- Rrjeti shperndares ne zone eshte jashte kushteve teknike

Persa më sipër del e nevojshme rritja e cilësisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, për këtë qëllim duhet te hartohet projekti i ndërtimit te rrjetit të tensionit të mesëm 20 kV dhe atij TU nga nënstacioni i 110/20/6kV Traktota .Rrjeti elektrik në këtë zonë ka nevojë për përmirësime pasi gjëndja teknike e tij është drejt amortizimit total dhe në disa pjesë plotësisht e amortizuar, zhvillimi urbanistik në këtë zonë ka sjellë rritje të kërkesës për konsum të energjisë elektrike, fuqia e instaluar në fidera është më e madhe se kapaciteti furnizues i tyre.

3.2. Qellimi i Projektit

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi i rrjetit te ri 20 kV per furnizimin me energji elektrike te zones se Golemit te paraqitur ne Figure 1. Ne kete zone duhet te parashikohet:

1. Zevendesimi i nje segmenti te fiderit C6 ekzistues 20 kV nga nenstacioni 110/20/6 kV Traktora nga linje ajrore ne linje kabllore.
2. Linja e re kabllore fillon nga Nenstacioni Traktora deri ne kabinen "Idriz Dollaku 2A" ne zonen Ali Demi, me nje gjatesi prej 6000 m ,duke eleminuar gjithe pjesen ajore te fiderit
3. Kabina e pare qe do te lidhet ne linjen e re kabllore ,eshte kabina ekzistuese box "" me TR 400kva dhe me pas kabina ekzistuese box "Kryegjyshata 3" TR 400kVA.
4. Do te shtohet nje kabine e re mini box "K2" me TR 400kVA te ri, duke eleminuar 5 kabina shtyllore "Private familjare Xhajat", "Shtyllore Mmajes", "Private Pasho Hyso", "Private A.Sinani" dhe "Shtyllore Anxhelo Kazo ".

5. Kabinat e reja box qe do vendosen do te furnizojne rreth 220 abonente te zones,qe merrnin furnizim nga rrjeti i vjeter ajror.
6. Ne kabinen ekzistuese box "Burgu 325" do te dale nje linje e re kabllore qe shkon drejt kabines ekzistuese "Eralb",duke e furnizuar kete kabine sipas skemes Hyrje-Dalje.

3.2.1. Rrjeti i ri TM 20 kV

Rrjeti i Ri 20 kV do te ndertohet me kablllo me izolacion XLPE Al 3 x 1 x 240mm². Pika e lidhjes per fiderin C6 ekzistues do te jene cela ekzistuese 20 kV ne nenstacionin Traktora 110/20/6 kV . Pjesa e re e fiderit C6 prej 6km do te lidhet ne unaze me fideri C3, ndersa kabinat e reja dhe ekzistuese do te lidhen sipas skemes hyrje – dalje. Ne kete menyre shmanget ne maksimum lidhja radiale e kabinave ekzistuese qe furnizoheshin si "Kryegjyshata 3" e deri tek kabina e fundit" Burgu 325" nga linja ajrore , kjo menyre lidhje te merret ne konsiderat vetem ne rastet kur perdorimi i skemes hyrje – dalje do te sillte nje rritje te konsiderueshme te gjatesise se linjes TM. Te kryhen te gjitha llogaritjet e linjave TM ne regjim normal dhe ne regjim avarie pune, grupi projektimit te verifikojte permbushjen e kushteve teknike ne te gjitha rastet.

Per rrjetin TM te jepet minimalisht:

1. Paraqitje grafike e trasese se linjes se re
2. Te percaktohen pikat e kryqezimit te linjes me infrastrukturen ekzistuese linja elektrike, kryqezime rruges, kanalesh kullimi etj.
3. Tipi i trasese ne cdo segment te linjes i perdorur per llogaritjen e volumeve te punes.
4. Prerjet terthore te kanalit te kablllove ne cdo rast
5. Parametrat elektrik te secilit fider
6. Detaje te tjera teknike te nevojshme per realizimin e punimeve

Te percaktohet pika e paralelit ndermjet fiderave te rinje per ngarkesat maksimale te cdo fideri ne regjim normal.

3.2.2. Kabinat e Reja dhe ato ekzistuese

Ne kete projekt kabinat e reja do te jene Tip BOX. Do te shtohen 2 kabina te reja tip mini box "K2" me TR 400kVA te ri dhe " Box Anxhelo Kazo" me TR ekzistues 100kVA Kabinat ekzistuese, ne pronesi te OSSH sh.a., te cilat permbushin kerkesat ne lidhje me hapsirat e nevojshme per paisjet e reja si dhe kane strukture te qendrueshme te rikonstruktohen. Ne rast se kabinat e OSSH sh.a. nuk kane hapsira te nevojshme ose nuk kane strukture te qendrueshme te demontohen dhe ne te njejtin pozicion te vendoset kabine e re BOX. Ne kete projekt nuk do te pranohet perdorimi i kabinave te reja shtyllore 20/0.4 kV. Kabinat e tjera jane "Idriz Dollaku 2A" ,"Idriz Dollaku" dhe te tjerat jane ne kushte te mira ,vetem do te realizohen zevendesimi i paisjeve elektrike sipas standarteve te OSSH.

Ne kabinat e reja do te perdoren trasnformatore me fuqi 250, 400 dhe 630 kVA. Ne te gjitha rastet kabinat e reja duhet te jene te pershtateshme per transforatore 630 kVA.

Metodologjia e percaktimit te fuqise se transformatorit do te jete:

1. Duhet te percaktohet fuqia maksimale me te cilen kontribone nje abonent ne pik. Kjo llogaritje mund te kryhet ne baze te numrit total te abonenteve dhe ngarkeses maksimale te zones. Fuqia maksimale me te cilen kontribon nje abonent ne pik do te shumezohet me numrin total te abonenteve qe ka kjo kabine. Ne kete rast kujdes te vecant duhet treguar me abonentet e medhenje te cilet jane lidhur ne rrjetin TU te kesaj kabine. Keta abonent duhet te identifikohen dhe te behet korigjimi perkates i fuqise se TR
2. Ne rastin e kabinave qe do te rikonstruktohen te merret informacion mbi gjendjen e transformatorit te kabines nese eshte i mbi ose nen ngarkuar dhe te percaktohet fuqia e TR ne kete kabine duke u mbeshtetur ne informacionin e mbledhur.
3. Transformoret e rinje sipas llogaritjeve te punojne ne pik me 80% te fuqise se tyre nominale

Per kabinat te jepet minimalisht:

1. Pamje e pergjitheshme te kabines
2. Detaje te kabines box (sipas specifikimeve) dhe atyre qe do te rikonstruktohen perfshire dhe planimetrine e vendosjes se paisjeve
3. Skema e seciles kabine dhe tarimet perkatese te automatit te seciles dalje TU ne varesi te ngarkeses qe do te marre
4. Pozicioni i rregullatorit te tensionit ne TR ne cdo kabine

3.2.3. Rrjeti i tensionit te ulet

Kabinat e reja box qe do vendosen do te furnizojne rreth 220 abonente te zones, qe merrnin furnizim nga rrjeti i vjeter ajror. Rrjeti TU i kabines se re "K2" te reja do te ndertohej Ajror me Kabllo Alumini me vetembajtje ABC ose me kabllo nentokesore me izolacion XLPE. Cdo kabine te ket nje numer maksimal dalje TU deri ne 4 cope. Ne cdo rast do te kryhen llogaritjet e daljeve TU dhe te ruhen reniet e tensionit brenda kufijeve te kodit te shperndarjes. Furnizimi i cdo abONENTI 1 fazore do te behet me kabllo koaksial.

Shtyllat e perdorura ne rrjetin TU te jene beton arme.

Per Rrjetin TU te jepet minimalisht:

1. Numri i abonenteve te cilet do te lidhen ne cdo shtylle,
2. Distanca ndermjet shtyllave,
3. Tipi i shtylles,
4. Seksioni i kabllit ABC per cdo kampat ose grup kampatash
5. Humbiet e tensionit ne secilen dalje

4. Vizatimet

Madhesia e vizatimit duhet te jete sipas series ISO A.

Masat normale jane minimum A4 (297 x 210 mm) dhe maksimum A0 (1,189 x 841) Printimet do te jene ne leter plotesisht te bardhe.

Cdo vizatim do të ketë stampen në pjesën e poshtme në krahun e djathtë me informacionet minimale si mëposhtme (modeli stampes së dërguar nga DPSMM):

- Emrin e Investitorit
- Emrin e projektit
- Emrin e vendit ku punohet
- Numrin e vizatimit
- Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së vizatimit
- Emrin e projektuesit
- Shkallen e vizatimit (në rastet kur aplikohet)

Veriu duhet të tregohet në të gjitha vizatimet e hartave e planimetrive. Planimetritë do të jenë në shkallë 1:1000. Detajet e Instalimit 1:50.

5. Specifikimet e materialeve

Te gjitha materialet që do të përdoren në realizimin e projektit të jenë në përputhje me standartet dhe specifikimet e OSSH sh.a.

6. Materialet që do të demontohen

Në preventivin e këtij projekti vlera për truallin e kabinave dhe për lejet e ndertimit nuk duhet të përfshihet. Të përfshihen në preventivin e objektit të gjitha materialet që do të demontohen në kabinat që do të rikonstruktohen dhe në rrjetin TU. Pjesë të vecanta të rrjetit TM të cilat mund të pengojnë realizimin e projektit të ri të përfshihen në demontime.

Të shprehet qartë në preventivin e objektit dhe në shenimet teknike se materialet e demantuara të dorëzohen në magazinat e OSSH sh.a.

7. Ceshtjet ambientale

Gjate hartimit të projektit të shmangen zonat e mbrojtura natyrore dhe historike. Gjate hartimit të projektit të bashkëpunohet me Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit në DPSMM me qëllim minimizimin e efekteve negative të realizimit të projektit në mjedis dhe të efekteve sociale.

8. Dokumentacioni

Nga grupi i projektimit të hartohet minimalisht dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Relacion teknik. Ky relacion duhet të ketë karakter shpjegues dhe duhet të përmbajë minimalisht informacionin e mëposhtëm:
 - a. Parimet baze ku grupi është mbështetur në realizimin e projektit,
 - b. Përshkrim të gjendjes ekzistuese së rrjetit në zonë,
 - c. Përshkrim të projektit të ri
 - d. Rezultatet e llogaritjeve,
 - e. Afati kohor i shlyerjes së investimit
 - f. Vlerësimin e pikezuar të projektit



2. Vizatimet dhe detaje
3. Preventivi, percaktimi i kostove te proejktit
4. Specifikimet teknike. Pas hartimit te projektit te kerkohet suporti i sektorit perkates ne DPSMM per plotesimin e projektit me specifikimet perkatese.

Dokumentacioni te pergatitet ne formatin elektronik dhe i printuar si me poshte:

1. Relacioni teknik, te printohet ne 5 kopje ne formatin A4 ndersa pjese te vecanta mund te printohen dhe formatin A3
2. Vizatimet dhe Detaje, te perdatitne ne PDF dhe te siglohen elektronikisht nga grupi projektitmi. Formatin i printimit sipas formatit te shprehur ne kapitullin 4, gjithashtu ne materialin e dorezuar vizatimet dhe detajet duhet te jene dhe ne formatin elektronik DWG
3. Preventivi i objektit. Te printohet ne formatin A4 ne 5 kopje. Gjithashtu duhet te pergatitet ne formatin per prokurim ne pdf (pa cmime) dhe ne formatin PDF identike sikurse eshte printuar ne hard copy i sigluar elektronikisht nga grupi projektitmi si dhe ne formatin elektronik excel.
4. Specifikimet teknike. Duhet te jene pjese e projektit vetem ne formatin PDF

I gjithe dokumentacioni elektronik i shprehur me siper te jepet ne CD dhe te jete i grupuar ne 3 foldera te vecante:

1. Materialet elektronike ne format Word, excel, DWG etj. Varianti perfundimtare i tyre ne kete folder duhet te perfshihen
 - a. Relacioni teknik (word)
 - b. Vizatimet dhe Detaje (DWG)
 - c. Preventivi i objektit (excel)
 - d. Specifikimet teknike (PDF)
2. Materialet elektronike ne format PDF per prokurim
 - a. Relacioni teknik (PDF – pa emrat e grupit te projektimit)
 - b. Vizatimet dhe Detaje (PDF – pa emrat e grupit te projektimit)
 - c. Preventivi i objektit (PDF – pa emrat e grupit te projektimit dhe pa cmime, vetem me volume)
 - d. Specifikimet teknike (PDF)
3. Materiale elektronike ne PDF te sigluara nga grupi projektimit
 - a. Relacioni teknik (PDF – me emrat e grupit te projektimit dhe i sigluar elektronikisht)
 - b. Vizatimet dhe Detaje (PDF – me emrat e grupit te projektimit dhe i sigluar elektronikisht)
 - c. Preventivi i objektit (PDF – me emrat e grupit te projektimit dhe me cmime dhe i sigluar elektronikisht)
 - d. Specifikimet teknike (PDF)

9. Realizimi i projektit

Grupi i projektimit ngarkohet per kryerjen e projektit te objektit per nje periudhe 3 mujore nga data e nxjerrjes se urdherit perkates per ngritjen e grupit te punes. Ne rast te gjetjeve te tjera nga grupi i



projektimit të cilat kanë nevojë për rishikim të kësaj detyre projektimi dhe do të çojnë në përmirësimin e projektit, atëherë do të kemi dhe rishikim të afatit të realizimit të projektit.

Miratoj Detyren e Projektimit

Shef I Degës Tekniike

